



NEWSLETTER

Shkurt 2025

Nr.2

Shënimi i 13 shkurtit – Dita Botërore e Radios

Nën kujdesin e UNESCO-s, më 13 shkurt u festua Dita Botërore e Radios, e cila këtë vit u mbajt nën moton "Radio dhe Ndryshimet Klimatike". Qëllimi i shënimit ishte rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe medias për rëndësinë e radios, për të inkurajuar marrësit e vendimeve që të krijojnë dhe sigurojnë qasje në informacion përmes radios dhe të forcojë rrjetëzimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar midis transmetuesve.

Në këtë drejtim, Agjencia informoi të gjitha radiot në vend se UNESCO ofron mundësinë e shkëmbimit të përvojave, materialeve dhe ideve me radio stacione nga vende të tjera, si dhe burime të dobishme falas, duke përfshirë video audio dhe vizuale me temën "Radio dhe ndryshime klimatike", materiale që lidhen me zhvillimin e mediave, arsimimin mediatik dhe informativ dhe sigurinë e gazetarëve; Udhëzues për informimin rreth ndryshimeve klimatike dhe gjenerimit të të ardhurave.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale të gjitha radiostacionet në vend uroi për Ditën Botërore të Radios dhe u bëri thirrje që të japin kontributin e tyre në shënimin e saj.

Mbikëqyrja e transmetuesve, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe mediave të shkruara Transmetuesit

Agjencia ka realizuar mbikëqyrje të rregullt administrative dhe programore mbi programet në radio të Ndërmarrjes publike radiodifuzive RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË- MRA 1, MRA 2 dhe MRA 3 në lidhje me detyrimet për publikim impresium, informacione që duhet t'i vihen në dispozicion përdoruesve, identifikimin e transmetuesit, rregullat për transmetimin e komunikimit komercial audio, detyrimet gjatë ofrimit të kuizeve ose formave të tjera të pjesëmarrjes, shfrytëzimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimi telefonik, transmetimin e lojrave të fatit, përdorimin e gjuhës në programet e transmetuesve, transmetim gjatë ditës së paku 18 orë program në radio dhe së paku 50% muzikë të transmetuar instrumentale, vokale dhe/ose vokale-instrumentale të krijuar burimisht në Republikën e Maqedonisë të jetë në gjuhën Maqedonase ose në gjuhën e bashkësive joshumicë (MPA2 të ofron së paku 30% të muzikës së transmetuar instrumentale, vokale dhe/ose vokalo-instrumentale burimisht të krijuar në Republikën e Maqedonisë të jetë në gjuhën maqedonase).

Pas kalimit të afatit për harmonizim ligjor me masat vërejtje publike, janë kryer mbikëqyrje të kontrollit programor për detyrime të ndryshme ligjore në TV Due, TV Protel, TV Spektra dhe TV Star. Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se TV Due në programin e transmetuar më 27 janar, para transmetimit të disa programeve të kategorisë së parë, dytë dhe të katërt është përdorur sinjalistikë paralajmëruese e pasaktë për mbrojtjen e të miturve, dhe nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase. Televizionet e mbetura vepruan sipas masave të shqiptuara më parë.

Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore mbi operatorët KDS-Kabel Net, Datakom JV, Skrembel, Drim Sat IPTV, Nafi dhe Beko, Vinsat Kabel dhe Kabel-Net për respektimin e detyrimeve për regjistrimin e shërbimeve programore, titrimin e shërbimeve programore që ritransmetojnë dhe për detyrimin në paketën programore që e ritransmetojnë detyrimisht dhe papagesë që të ofrojnë shërbimet programore të Shërbimit publik radiodifuziv. Gjatë mbikëqyrjes nuk janë konstatuar shkelje të dispozitave të LSHMAAV.



NEWSLETTER

Media e shkruar

Mbi botuesit e mediave të shkruara EPRO PRINT botues i "Nova Makedonija", SLOBODEN PEÇAT botues i "Sloboden Peçat", VEÇER PRES botues në "Veçer", KOHA PRODUCTION botues në "Koha", KAPITAL MEDIA GROUP botues i "Kapitalit". "Bahçe", MEDIA PLUS FOKUS botues në "Fokus", JENI BALKAN botues i "Bahçe", ATV MEDIA KOMPANI botues në "Lajm", EURO-MAK KOMPANI botues i "Ekonomija dhe biznesi", ANTIQ MEDIA botues në "Portret", KOLOR MEDIA PLUS botues i "Bukurisë dhe Shëndetit", BIRO PRES botues i "Porta 3", EMITER botues në "Emiter", NARODEN LEKAR botues në "Mjeku popullor", MEDIUM BOJA 43 botues në "Shtipski glas", VIZIONI M botues në "Shenja", ZENIT PRESS PLUS botues i "Zenit", PABLIK botues në botues "Lice v Lice" dhe KLIKER MARKETING botues i "InStore", Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative për detyrimet e publikimit impresium, të dhëna për selinë, shtypshkronjën, datën e shtypjes ose ribotimit, dhe numrin e kopjeve të shtypura si detyrim nga Ligji për Media. Mbikëqyrja rezultoi se mediat e shkruara plotësisht e kanë përmbushur detyrimin ligjor.

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të kontrollit administrativ mbi Kolor Media Plus, botues i medias së shkruar "The Economist", për të përcaktuar nëse ka vepruar sipas Akvendimit për ndërmarrjen e masës vërejtje publike, drejtuar për mospublikim të emrit dhe adresës së selisë dhe redaksisë së botuesit të medias; emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias; emrin dhe mbiemrin e redaktorit përgjegjës, përkatësisht redaktorët, adresën e shtypshkronjës dhe datën e shtypjes ose ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të shtypura. Nga mbikëqyrja është konstatuar se media e shkruar ka vepruar plotësisht sipas aktvendimit për ndërmarrjen e masës.

Masat e shqiptuara vërejtje publike

Këshilli i Agjencisë, në seancën e 8-të mbajtur më 24 shkurt, për mosrespektim të dispozitave të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Ligjit për Media shqiptoi masa vërejtje publike për TV Njuz dhe TV DUE.

Televizionit NJUZ i është shqiptuar masë vërejtje publike për shkak se nuk ka ofruar informacion që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve dhe për mospublikim të të dhënave për impresium, ndërsa televizionit DUE është shqiptuar masë vërejtje publike për sinjalistikë parajlmëruese të gabuar për mbrojtjen e të miturve, si dhe për mosrespektim të detyrimit ligjor për transmetim së paku 30% të veprave audiovizive maqedonase.

Në seancën e 7-të mbajtur më 19 shkurt, Këshilli i Agjencisë për shkak të mos ofrimit të informacionit që duhet t'i vihet në dispozicion përdoruesve, kanalit të tretë të programit televiziv të shërbimit publik - RTM 3, i ka shqiptuar masë vërejtje publike.

